



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2023:026216  
Datë: 27.03.2024  
Numri i dokumentit: 05511153

2023:026217

Gjykata Themelore në Ferizaj, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.Z. nga Ferizaj, me numër personal ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Admir Salihu nga Ferizaj kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit jomaterial dhe material, me vlerë të kontestit të pacaktuar, më dt. 27.03.2024 mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Konstatohet tërheqja e padisë së paditësit E.Z. nga Ferizaj kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, e paraqitur me datë 30.01.2023 me objekt kontesti kompensim i dëmit jomaterial dhe material.
- II. Obligohet paditësi E.Z. nga Ferizaj, që në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, të paguajë në xhironlogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, shumën prej 20,00€ në emër të taksës gjyqësore për parashtrimin e padisë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Arsyetim

Me datë 30.01.2023 paditësi ka paraqitur padi kundër të paditurit me objekt kontesti kompensim i dëmit jomaterial dhe material. Paditësi para caktimit të seancës përgatitore, përmes të autorizuarit të tij av. Admir Salihu nga Ferizaj i kanë dorëzuar me dt. 14.03.2024 gjykatës parashtrësë në të cilën theksojnë se e tërheqin padinë kundër të paditurit meqë në ndërkohë palët ndërgjyqësore kanë zgjidhur çështjen konkrete me marrëveshje dhe në mënyrë të qetë, në shtojcë: Aktmarrëveshje nr. ... për pranimin e vlerës dhe kompensimit të dëmit të pësuar material dhe jomaterial, vlera e kompensimit 1,060€ (800 euro për të dëmtuarin për të gjitha format dhe llojet e dëmit dhe 260 euro për shpenzimet e përfaqësimit: padia 104€, seanca 135€ dhe taksa për padi 21€).

Prandaj gjykata me aplikimin e nenit 261.2 të LPK lidhur me nenin 381.1, pika c) të LPK nxjerrë aktvendim si në dispozitiv dhe konstatohet tërheqja e padisë.

Gjykata vendosi si në pikën II. të këtij aktvendimi bazuar në Udhëzimin Administrativ të KGJK lidhur me unifikimin e taksave gjyqësore, nr. 01/88, i datës 22.03.2017, pika 12.1, duke pas parasysh faktin se paditësi nuk e ka paguar taksën për padi në momentin e dorëzimit të padisë në gjykatë si dhe as pas vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore të dërguar përmes postës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e konform nenit 142 të LPK u vendosë si në dispozitiv.

Gjyqtari,  
Armend Ahmeti

Udhëzimi mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 261.4 të LPK.